



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 09.09.2015, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 10.273, datë 29.4.2010 “Për dokumentin elektronik”.
2. Projektligji “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Oerd Bylykbashi, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Pandeli Majko, Dashamir Peza, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Petrit Vasili, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Mhill Fufi, Tahir Muhedini, Nard Ndoka.

Mungojnë:

Anila Agalliu, Silva Caka, Tom Doshi

Të ftuar :

Milena Harito - ministre e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

Edlira Llango - drejtoreshë e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë me mbledhjen e komisionit.

Në rendin e ditës kemi dy projektligje të rëndësishme, që lidhen me ministren e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, zonjën Milena Harito si iniciuese e këtyre dy projekteve të ardhura nga qeveria.

Zonja Harito është e pranishme në këtë mbledhje komisioni për të bërë një paraqitje të përmbledhur të projekteve, si dhe për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të kolegëve apo komenteve, që mund të adresohen prej tyre.

Fillimisht, do të sugjeroja, besoj se biem dakord, ato kanë përafërsi me njëra-tjetrën të kemi mundësi që ministrja të bëjë një prezantim për të dyja dokumentet.

Sot do të shqyrtojmë vetëm projektligjin e parë. Projektligjin e dytë nëse ka diçka në parim mund të pyesni, por këshilltarët kanë kërkuar pak më shumë kohë, për të reflektuar mbi dokumentin së bashku me relatorin që t'i japin mundësi vetes për të shqyrtuar disa elemente, që kanë nevojë të studiohen me kujdes. Ne nuk kemi arsye pse të mos i vlerësojmë pretendime të tilla.

Zonja Harito, ju lutem, urdhëroni!

Milena Harito – Mirëmëngjesi, të gjithëve!

Faleminderit, zoti kryetar!

Të dyja këto projektligje kanë një qëllim të përbashkët: përmirësimin e shërbimeve për qytetarët. Ne të gjithë jemi të ndërgjegjshëm që shërbimet që marrin sot qytetarët tanë në sportelet e shtetit lënë ende shumë për të dëshiruar. Për këtë arsye një nga zotimet tona në programin qeverisës ka qenë përmirësimi i shërbimeve, që është rritja e shërbimeve *online*.

Pra, sa më shumë shërbime të merren *online*, aq më tepër i pritet rruga korrupsionit, aq më tepër qytetarët marrin shërbimet në mënyrë të menjëhershme dhe aq më tepër u lehtësohet jeta.

Për të gjitha këto ka një kuadër ligjor i cili duhet përforcuar. Ajo që të gjithë e kemi të nevojshme të kuptojmë është që ekonomia *online*, është duke u rritur në mënyrë të ndjeshme dhe kjo varësisht ose pavarësisht vullnetit tonë do të ndodhë, sepse është një

proces që ndodh në të gjitha vendet. Pra, kjo pjesë e ekonomisë është vazhdimisht në rritje dhe për këtë arsye kjo pjesë e ekonomisë duhet të rregullohet. Pra duhet të ketë një kuadër rregullator, i cili vjen në përmirësim të vazhdueshëm.

Këtu kemi dy projektligje:

I pari është një shtesë në ligjin ekzistues, që është ligji i dokumentit elektronik. Për ta shpjeguar sa më thjesht, ligji i dokumentit elektronik ka bërë të vlefshëm në Republikën e Shqipërisë dokumentin elektronik në të gjitha institucionet, gjykatat, institucionet shtetërore. Fakti është që një pjesë e institucioneve kanë vështirësi ta aplikojnë këtë gjë, për arsye të ndryshme që ndonjëherë janë teknike si: furnizimi me internet, ndonjëherë është mosdija, ndonjëherë është mosdëshira, por fakti është që ky ligj, i cili ekziston, nuk aplikohet gjerësisht, pra, nuk arrin t' u lehtësojë jetën qytetarëve.

Për këtë arsye kemi propozuar një shtesë në këtë ligj, e cila mundëson që qytetari të ketë mundësinë ta printojë dokumentin elektronik nga shtëpia, pra, pa shkuar në sportelet e shtetit dhe nëpërmjet një kodi specifik, pra, ato që quhen *flash code*, që tani i shikojmë kudo në ekonominë dhe shoqërinë tonë. Ky dokument të identifikohet edhe në letër dhe të jetë i përdorshëm në të gjitha institucionet edhe kur ato refuzojnë të përdorin drejtpërdrejt dokumentin elektronik, që është i vlefshëm, siç e thashë.

Të gjitha institucionet sot duhet ta pranorin, por siç e dimë, këto janë ndryshime mentaliteti, kërkojnë kohën e tyre dhe për këtë arsye ne përpiqemi të fusim një shtesë, që lehtëson përdorimin e këtij instrumenti.

Kjo është për shtesën, pra, për ligjin për dokumentin elektronik që është një ligj ekzistues.

Ndërsa, projektligji i dytë që është për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara është një ligj i ri që sjellim, është një transpozim i një direktive europiane të re.

Çfarë bën ky projektligj? E thënë me pak fjalë, ky projektligj bën që identifikimi elektronik në portalet ku merren shërbimet të jetë i sigurt. Pra, vendos elementet e sigurisë, në mënyrë që dikush të mos futet në emrin tim dhe të kërkojë shërbim në emrin tim. Rregullon edhe diçka tjetër që nuk ekzistonte më parë, që është vula elektronike.

Pra, me projektligjin ekzistues të rregullohej vetëm nënshkrimi elektronik, firma elektronike. Nëpërmjet këtij projektligji futet edhe nocioni i vulës elektronike. Pra,

institucioni si i tillë ka mundësi që të gjithë qarkullimin e dokumenteve ta bëjë në mënyrë elektronike.

Të gjitha këto janë të mbështetura në direktivat europiane dhe njëkohësisht ne na ka lindur si një nevojë për t'i bërë sa më shpejt, sepse nëse e keni pasur rastin ta dëgjoni, kemi rritur në mënyrë shumë të ndjeshme numrin e shërbimeve *online* dhe që këto shërbime të përdoren realisht nga qytetarët u duhet ofruar ky kuadër garantues, që krijon besueshmërinë e nevojshme në mënyrë që ata t'i përdorin realisht këto shërbime *online*.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Pandeli Majko – Besoj se të gjithë kolegët e kanë përpara relacionin. Unë nuk dua të zgjatem. Kam vetëm një pyetje që është paraqitur edhe në relacion për dokumentin elektronik. Kurse në përgjithësi dua të them që përbën një evolucion ky ndryshim në ligj. Pra, përbën një revolucion në marrëdhëniet me qytetarin me administratën. Nuk dua t'i shtoj asnjë presje atyre që tha ministrja. Jam i hapur për çdo lloj vërejtje apo pyetje nga kolegët.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Majko!

Ka pyetje?

Në relacion ka një pyetje, vërtetimi i kopjes në letër do të vazhdohet të kryhet nga personat e autorizuar nga titullari i institucionit apo do të mjaftojë vetëm nga vendosja në kopje e kodit 2 dimensional?

Milena Harito – Qytetari do të mund ta printojë vetë dokumentin dhe ky është evolucioni. Pra, nuk do të ketë nevojë ta bëjë këtë gjë nëpunësi. Kodi 2 dimensional është garanti që ky është dokument i lëshuar nga shteti.

Kjo mundëson që kur qytetari shkon me këtë kopjen në letër në një zyrë tjetër ata nëpërmjet kodit verifikojnë që dokumenti është i vlefshëm.

Fatmir Xhafaj – Me pak fjalë eviton çdo lloj burokracie për këtë gjë.

Dakord. Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet në parim.

Kush është dakord me nenin 1?

Po, zoti Majko, urdhëroni!

Pandeli Majko - Është një riformulim “Kodi nacional është logografik i besueshëm nga sistemet kompjuterike, e cila përmban të gjitha të dhëna dhe/ose informacione të koduara në format numerike, alfa-metrik dhe binar”.

Fatmir Xhafaj – Dakord?

Milena Harito – Po, është në rregull.

Fatmir Xhafaj - Kush është dakord me ndryshimet e nenit 1? Kundër? Abstenim?
Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Mbaruam me ligjin e parë.

Për projektligjin “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.

Zoti Muçmataj, si do të veprojmë? Të bëjmë një paraqitje nga ana juaj tani apo...

Vexhi Muçmataj – Mendoj ta kalojmë në parim sot dhe për sa i takon shoqërimit penal ta kalojmë në një seancë tjetër, për shkak se jemi në konsultim me përfaqësuesit e qeverisë për ta parë më me kujdes.

Oerd Bylykbashi – Nëse ka nevojë për t’u parë, dakord, sepse është një ligj i ri, ka kompleksitetin e vet. Në qoftë se relatori ka nevojë të konsultohet ende, po atëherë na lind nevoja ta shikojmë. Kështu që prezantimi u bë. Në një seancë tjetër... Në qoftë se e votojmë në parim sot...

Fatmir Xhafaj – Prezantimi u bë. Kërkesa e relatorit është për t’i dhënë kohë për të reflektuar më shumë meqenëse është një dokument ...

(Mungesë incizimi.)

Dakord e mbyllim këtu seancën e sotme.
Nesër është e enjte. Kemi seancë plenare.
Gjithë të mirat!

MBLEDHJA MBYLLET